



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

Komuna e Klinës

Zyra e kryetarit

Klinë, 17. 12. 2020

MINISTRIA E PËRSHTRUJUE KOMUNA E KLINËS

Ditë: 04, 01, 2021

Nr. 01-06-3986 /21

## PROCESVERBAL

**Nga takimi I dytë I kryetarit të Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj me qytetarët e Komunës së Klinës, mbajtur me datë 17. 12. 2020 në sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora 10:00**

Kryetari z. Elezaj falënderoj qytetarët pjesëmarrës në këtë takim duke jua bërë të ditur që në vazhdim në pikë të shkurtra do të ju jap informacion dhe një raport për punën e bërë të ekzekutivit.

**z. Zenun Elezaj, krytar I Komunës:** Të nderuar qytetarë ju falënderoj që keni gjetur kohë të vini në takim dhe të dëgjoni reportin e punës së ekzekutivit. Ju informoj se përkundër situatës së rënduar me pandeminë, Komuna e Klinës nuk ka ndaluar që të realizoj projekte në të mirë të qytetarëve. Ishim në dispozicion të qytetarëve përmes, dëgjimit, takimeve të shumta dhe drejtimit të kërkesave të shumta të tyre. Në këtë kohë të pandemisë janë përkrahur familjet skamnore me pako ushqimore dhe higjienike dhe miell. Janë ndihmuar raste të ndryshme skamnore dhe shëndetësore, janë ofruar shërbime mjekësore në QKMF dhe AMF dhe janë formuar ekipet mobile për dhënen e shërbimeve në shtëpi. Janë përkrahur fermerët përmes investimeve në kanalet e ujitjes si dhe pajisjen e tyre me multikultivator, pajisje për spërkatjen e pemëve, makina mijelëse etj. Në qytet dhe fshatra janë regjistruar një numër i madh I projekteve. Duke e pasur parasysh se buxheti total për vitin 2020 ka qenë 11 milion e 786 mijë e 857 euro, atëherë realizimi I tij deri sot është 9 milion e 695 mijë, ose rreth 82% e buxhetit. Pagesat nga kategoria ekonomike si pagat dhe shtesa janë 5 milion e 708 mijë euro, ose 92 % e buxhetit për paga. Pagesat nga kategoria mallra dhe shërbime 86.18% është realizuar deri me tanë. Pagesat për shërbime komunale 72.4%. Pagesat nga kategoria e subvencioneve 63.56% dhe pagesat për shpenzimet kapitale, kuptohet janë 64.57%. Të hyrat e deritanishme janë në vlerën e 915 mijë e 74 euro, që janë rreth 17.6% më pak se sa t'hyrat e vitit të kaluar në intervalin e njëjtë kohor. Gjatë kësaj periudhe janë proceduar 142 procedura prokurimi, prej tyre 50 procedura janë furnizime, 35 procedura janë shërbime dhe 57 procedura janë projekte kapitale. Vlera e kontratave të lidhura deri me tanë është 3 milion e 768 mijë e 261 euro. Kuptohet ky vit ka qenë një vit I vështirë I shoqëruar me problemet e pandemisë që është vit karakteristik për tërë boten. Përveç kësaj kanë qenë edhe dy tre çështje të tjera që na e kanë vështirësuar, flas në kontest të buxhetit, siç është kontrata kolektive për shujta dhe paga jubilare për punëtorët e arsimt. Diku te 900 mijë euro janë mjete që duhej të paguheshin, të ardhura nga vendimet

e gjykatave dhe inspektoratit. Pra, një pjesë dërmuese e tyre është arritur që të realizohen përmes vendimeve të kuvendit komunal. Gjithsejtë 374 mijë e 484 euro janë paguar obligime ndaj arsimtarëve pasi që nuk ka pasur padi në gjykata. Ndërsa vlera tjetër 532 mijë euro është obligim për të njëjtën kontratë kolektive por që kjo pjesë është në përmbarues dhe komuna e Klinës ka nënshkruar marrëveshjen që këto mjete të realizohen. Arsimtarët përmes avokatit të tyre e kanë dërguar lenden në thesar për përmbarim dhe pasi që është obligim ligjor, ne presim që dita ditës ata ti marrin mjetet nga buxheti komunal në interes të arsimtarëve. Për të cilën ne disa herë I jemi drejtuar thesarit që këto mjete të realizohen. Në kuptim të gjitha këtyre, projektet e investimeve kapitale janë në mbarëvajtje dhe realizim të tyre. Shkaku I problemeve të mos aprovimit të buxhetit shtetëror në fillim të vitit, këto projekte kanë nisur me vonesë por pasi që koha ka qenë e mirë dhe e përshtatshme për punime, ato janë në kohë. Besoj që të gjitha këto projekte janë në interes të qytetarëve dhe do të ju shërbejnë përmirësimit të jetës së tyre. Një çështje tejet e rëndësishme është furnizimi i qytetarëve me ujë të pijshëm, më lejoni të jap pak informacione në lidhje me këtë. Pavarësisht se ky vit ka qenë I vështirë, angazhimet tona të një pas njëshme kanë bërë që projekti i furnizimit me ujë të pijshëm tani më për fshatrat lindore të Komunës së Klinës, pra duke filluar nga Perqevë deri në Caravik para një muaji a filluar. Është përfshirë edhe fshati Stupë I cili furnizimin me ujë do ta ketë nga ujësjellësi I Pejës. Plan dinamik I tyre është një vit, d.m.th. diku në muajin tetor do të kryhet. Kërkesat tona kanë qenë që të fillo furnizimi me ujë në Kohen e vështirësive për furnizim dhe kemi marrë pretime nga donatorët që do të bëhet e mundur furnizimi diku nga muaji qershori dhe korrik. Ky projekt kap vlerën prej 1.5 milion euro. Në të njëjtën kohë kemi realizuar një projekt afër fabrikës së ujit ku po bëhet thellimi I basenit dhe edhe aty do të kemi një sasi shtesë të ujërave por jo zgjidhje të problemit. Për një zgjidhje afatshkurtër të këtij problem kemi realizuar marrëveshje mirëkuptimi me Ministrinë e Ambientit dhe Ekonomisë dhe "Hidrodrinit". Vlera e këtij projekti është 800 mijë euro dhe Komuna e Klinës do të participoj më 200 mijë euro. Tani pritet realizimi I procedurave tenderuese nga Ministria e Ambientit. Parashikohet që nga muaji qershori të realizohet ky projekt dhe të kemi edhe 100 litra/s ujë të pijshëm për qytetin e Klinës, them nëse gjithçka shkon mirë dhe me kohë me procedurat e prokurimit. Pra, ky do të jetë angazhimi I ynë për zgjidhjen e problemit të ujit të pijshëm pasi që 100L/S do të jetë sasi e mjaftueshme vetëm për qytet ndërsa furnizimi për fshatrat lindore të Komunës do të bëhet direkt nga burimi I "Pusit të Jarinës" përmes një sistemi të veçantë të pompave ku planifikohet kapacitet deri në 60L/s. Ky vit ka qenë një vit I vështire për furnizim me ujë të pijshëm. Ne jemi munduar që përmes cisternave të bëjmë furnizimin e rregullt dhe të nevojshëm me qellim që të zbusim sadopak nevojën që ata kanë pasur këtë vit. U mundova që në pikë të shkurtra të jap një informacion për punën e ekzekutivit për këtë vit që po lëmë pas. Tani jam I hapur për debat dhe të dëgjoj kërkesat dhe shqetësimet e juaja.

**z. Gjon Lazri, Zllakuqan:** Përfaqësoj familjet Llazraj, Përlaskaj, Kqiraj dhe Laskaj. Dua të flas për projektin "Renavica" I cili është duke u kryer. Sipas punë kryerësit dhe projektit, janë 405 metra gjatësi. Këto 405 metra nuk mjaftojnë që të kryhet deri në Lumin Drin, ashtu qyshe kemi kërkuar ne dhe na është premtuar. Për 60 metra mbetët mangët dhe ajo është pjesa më vitale dhe më e dëmtuar e "Renavicës". Dëshiroj që ta diji arsyen e kësaj mungese.

**z. Zenun Elezaj, kryetar I Komunës:** Faleminderit. Po përgjigjem menjëherë. Besoj që ky është një projekt I rëndësishëm që po implementohet me sukses. Ne kemi proceduar sipas mundësive buxhetore që kishim në vitin e kaluar. E kam vizituar disa herë atë lokacion dhe punimet që po bëhen, këtë vit do të shohim mundësitet buxhetore që ta vazhdojmë ashtu siç e kërkoni pasi që po është shumë ë vërtetë që ato 60 metra janë shumë të rëndësishme pasi që bëhet shkarkimi I ujërave të zeza aty. Besoj që ky

problem do të zgjidhet me realizimin e studimit për ndërtimin e impiantit ë ujerave të zeza. Kemi kompaninë kontraktuese e cila projektin e investimit do ta kryej deri ne fillimin e viti të ardhshëm.

**z. Zef Duhani, Radulloc:** Kam shumë pyetje për kryetarin. Pse ne lagjja e Duhanve që sa vite vuajmë për ujë? shumë kërkesa ke edhe ti edhe nënkyetari e që ju as përgjigje nuk jepni. Arsyen të na shpjegoni. Shkaku I situatës dhe menaxhimit tuaj sot nuk jetojnë as 200 banorë në fshat edhe pse dikur I kemi pasur rrëth 700banorë. Kemi bërë shkresë edhe avokatit të popullit dhe përgjigja e juaj përmes tij ka qenë se ne do a marrim ujin nga fshati Kyrshëvë e Vogël që është diku 3500 metra larg. Gjithashtu në lidhje me përkrahjen e bujqve. Unë si bujk me 20 hektarë tokë kam bërë shumë kërkesa për përkrahje nga Komuna por mendoj që kryetari me bashkëpunëtorët e vetë as që I ka lexuar ato shkresa. Vitin e kaluar kam aplikuar që të më hapet një bunar por përgjigja ka qenë se gjoja nuk mund të futet aty makina për shpim ndërsa më vonë unë vet me shpenzime të mia e kam futë makinën aty dhe e kam kryer. Po ashtu edhe këtë vit kam aplikuar për pajisje me një goldon, I kam shkruar kryetarit, kam bërë kërkesë por deri tani nuk kam asnjë lajm pozitiv. Këtë vit kam pasur dëmttime edhe në kulturën bujqësore nga breshëri dhe kam bërë kërkesë për ndihmë por as komuna e as Ministria e cila thotë se nuk I ka ardhë kërkesa nga Komuna, nuk më kanë ndihmuar. Edhe rrugën e cila ka qenë 500 metra gjatësi e shtruar me zhavorr dhe e kalueshme, ju na keni shtruar vetëm 150 metra asfalt duke e dëmtuar pjesën tjetër të rrugës dhe bërë të pa kalueshme.

**z. Zenun Elezaj, kryetar I Komunës:** Zef, edhe ti personalisht edhe krejt Radulloci jeni pajisur me kanalizim për ujëra të zeza. Edhe me rrugë të asfaltuar derë me derë. Ajo rrugë për të cilën po flet është rrugë fushore dhe ne jemi duke bërë asfaltimet tani të rrugëve që dërgojnë deri në shtëpi. Asfaltin e ke në derë të shtëpisë, kanalizimin e keni në derë të shtëpisë. Ndërsa shqetësimin që ke përfurnizim me ujë, ne e kemi trajtuar me seriozitet, e din edhe ti edhe të gjithë bashkëfshatarët e tuaj, që ai është një problem më I hershëm se gjoja lagja e juaj nuk ka participu në ujësjellësin që e ka ndërtuar fshati. Ne jemi duke u munduar që ta rregullojmë këtë çështje. Vitin e ardhshëm do të jetë prioritet rehabilitimi I ujësjellësit përfshatin Krushevë e Vogël ku planifikohet që në këtë rrjet të kyçeni edhe ju. Avokatit të popullit I kam kthyer përgjigje me të dhënat që I kam disponuar. Tek bujqësia dhe subvencionet, është një komision vlerësues dhe të them të vërtetën nuk jam përzier fare në kompetencat e tyre. Sidoqoftë çdo ankesë dhe çdo shqetësim që keni mund të adresoni tek Komisioni që ka bërë vlerësimin. Natyrish që ka edhe procedura dhe instance të tjera që e mbikëqyrin atë vlerësim.

**z. Zafer Gashi:** Profesor, raportin që e prezantove mendoj që është raport përbajtjesor dhe prezanton rezultate që qytetari I prek për çdo ditë. Mund të jenë premtimet elektorale të realizuara tuajat dhe do të ishte mirë që të merrni lëvdata. I nderuar profesor. Po e shoh një lloj, ndoshta është e rendë që ta përdori, që mos ta personalizoj, për përbaljen e përditshme me pandeminë jam I vetëdijshëm që keni marrë disa masa mbaze në bazë të kapaciteteve që keni si Komunë. Se a duhet të bëhet më mirë dhe përpjekjeve të mia si profesionist, shpeshherë jam trajtuar keq, edhe nga ju edhe pse nuk e keni shprehur por që heshtjen tuaj si mënyrë e komunikimit me mua e konsideroj jo të duhur. Mendoj që duhet të bashkohemi më shumë rrëth kësaj sepse lajmet që vijnë nga shkenca flitet për një lloj të ri të virusit- mutacion shumë herë më të fuqishëm. Ne duhet të analizojmë dhe të shohim se çfarë do të bëjmë nëse do të përballemi me të. Tani që është pushimi I nxënësve, a keni ndërmarr ndonjë gjë që klasat të dezinfektohen dhe të përgatiten përfillimin e gjysmë vjetorit të dytë? Po ashtu në lidhje me pandeminë a keni ndarë buxhet më të madh përfurnizim me barna në mënyrë që mos t'ë kemi barna veç për një javë por për kohë më të gjatë. Fondi që keni ndarë ka qenë shumë I vogël, por shumë I mirëseardhur. I diji mundësitetë financiare të kufizuara të Komunës por a planifikoni të ndani fonde të

tjera emergjente për furnizim me medikamente nëse ndodhë një valë e tretë e pandemisë. Në fund më intereson ë dijë më shumë për prokurimin e fundit të realizuar nga Komuna lidhur me shëndetësisë. Si kanë qenë çmimet e iliqeve dhe kush ka fituar tenderin përfunduar. Profesor Inderuar ju prezantua shumë suksese, shumë rezultate por që në lokacionin e Sferkës ka shumë hapësirë përmirësim. Nuk dua të ndalem në disa raste që pak a shumë prekin edhe aspekta të mijat personale, më shumë jemi të shqetësuar nga një kompani e cila që 7 vite po merret gjoja me instalimin e kabllove elektrike. Profesor Inderuar, ka ardhur deri tek konflikti fizik I familjarëve të mijë me kompaninë "Rukolli" e cila kompani është futur në oborrin tim dhe e ka prishur oborrin. Ata thonë se ju I keni drejtuar. Futen ne oborr hapin kanale përfunduar të future kabllo elektrike dhe thirren në emrin tënd dhe të Lorenc Marlekut. Ajo që unë dua të them është se duhet të ketë përmirësimë në drejtorinë e shëndetësisë, në drejtorinë e Urbanizimit, ne drejtorinë e Kulturës. Në fund fare. Inderuar profesor, sot bëhen pesë muaj që unë kam kërkuar një ndihmë nga ju për Një rast të veçantë. Fjala është përfunduar Behije Gashin, kërkuesi që juva ka drejtuar juve ja kam shkruar unë. Ajo është një nënë që kujdeset përfundimisht 8 vjeç. Burri I sajë ka vdekur pas lufte nga tuberkulozi dhe ka qenë ushtar I UÇK-së. Të kam kontaktuar përfunduar këtë rast në zyrën tuaj dhe keni premtuar që jo vetëm strehim por edhe do të ndani mjete që tre muaj të ja paguani banesën. A keni arritur që ta strehoni zonjën në fjalë sepse skam informacione që po. Kërkoi falje përfundim që morra në këtë debat.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Faleminderit dr. Zaf. Po filloj nga kjo e fundit. Besoj që unë e kam firmosur një ndihmë financiare përfunduar rastin që e kemi biseduar. Nëse të duhet konfirmim, kabineti im e sjell tani. Përsigurimin e strehimit e dini edhe ju që kemi vështirësi. Jemi duke u munduar që përmes ndërtimit të shtëpisë të ju dalim në ndihmë këtyre kategorive. Kemi pasur bashkëpunim dhe shfrytëzoj rastin që të falënderoj "Jetimët e Ballkanit" organizatën e cila ka ndërtuar 10 shtëpi këtë vit dhe do të vazhdojë të ndërtoj edhe në të ardhmen. Edhe shoqatën "Nëna Terezë" e falënderoj gjithashtu. Sa I përket Covid-it, kemi bërë aq se kemi pasur mundësi por jam I vetëdijshëm që jo aq së ka qenë nevoja. Shfrytëzoj rastin që të falënderoj të gjithë stafin e QKMF-së. ordinancat private të cilat kanë dhënë shërbime specialistike, përfshi edhe ordinance tuaj. Sa I përket pandemisë, ne, gjithmonë duhet të I referohemi institutit të shëndetit publik të Kosovës. Unë jam I hapur përfunduar bashkëbisedim dhe konsultime me të gjithë e sidomos me juve që jeni profesionist I punës dhe keni të arritura të mëdha në këtë fushë. Ti e din që ne duhet të respektojmë protokollet zyrtare që ju vijnë QKMF-së nga linja zyrtare e IKSHK-së. Sa I përket sasisë dhe ndihmave, kemi pasur në fillim një pako ushqimore dhe higjenike e më pastaj kemi pasur edhe dy procedura që janë 62 mijë euro në vlerë vetëm përfundim të Covid-t. Besoj që të gjitha këto janë në web të Komunës dhe janë të detajuara. Në qoftë se nuk arrin që të I gjesh, atëherë unë kërkoi nga drejtori I Drejtorisë së shëndetësisë që të ti sjellë ato dy kontrata. Vështirësitë përfunduar me barna I dini edhe ju, këto ditë ka pasur problem furnizimi me FRAKSIPARINE por siç e pashtë dje një informacion do të rregullohet së shpejti. Përfunduar Sferkë, tek kanalizimi kemi bërë disa ndërhyrje dhe do të bëhen disa përmirësimë të mangësive që ka pasur projektin I realizuar më herët. Ndërsa përfunduar me ujë përfunduar Volljak dhe Qupevë është në procedurë nënshkrimi I kontratës përfunduar ndërtimin e ujësjellësit të ri. Me rastin e ndërtimit të këtij ujësjellësit përfunduar këto dy fshatra do të bëhet edhe ndarja e tyre nga ujësjellësi I fshatit Sferkë duke e bërë të mundur që Sferka të ketë sasi më të madhe të ujit. E tëra kjo është në kompetenca të "Hidrodrinit" por që kërkuesat e miajë të vazhdueshme janë që të ketë menaxhim më të mirë të "Hidrodrinit" të këtyre aseteve dhe shërbimeve. Sheshi I qytetit është një projekt më I vjetër dhe tani po bëhen edhe lidhjet e fundit të ekonomive familjare. Jam I informuar përfunduar që keni pasur por ndoshta jo në detaje, sidoqoftë dera ime është e hapur që ti diskutojmë të gjitha vështirësitë që dalin. Nuk e diji nëse arrita që të përgjigjem në të gjitha çështjet që I

shtrove por besoj çfarëdo që të keni mund të takohemi dhe të bisedojmë. Unë kam interes që të kam këshillën tende, interesimin tënd sepse gjatë tërë kësaj kohe keni ndihmuar qytetarët në vështirësitë pandemike.

**Znj. Kristina Lazri:** Përshëndetje kryetar. Kam disa pyetje që do të l formuloj shumë shkurt dhe besoj që do të kem përgjigjen e duhur. Një falënderim për të gjitha investimet që janë bërë në fshatin Zllakuqan. Në lidhje me fshatin Zllakuqan kam një pyetje për ujin e pijshëm. Si keni menduar që ta zgjidhni këtë. Pyetje tjetër, rreth çështjes së drejtorisë së kulturës, pse në komunën tonë u morr vendim që të pezullohen të gjitha aktivitetet kulturore dhe sportive ndërkokë që në Komunat e tjera nuk janë ndaluar, ato po mbahen natyrish duke respektuar udhëzimet e IKSHK-së. Prej që janë ndaluar të gjitha aktivitetet e tillë, nga muaji mars nuk kemi mbajtur asnje aktivitet prandaj nuk e dimë se ku po shkon buxheti I ndarë I kësaj drejtorie. Ajo që më ka shqetësuar mua si ish drejtore e kulturës dhe sportit është organizimi I festivalit folklorik I mbajtur ditëve të fundit I cili me vendim të asamblesë është anuluar që të mbahet këtë vit. Ky festival është organizuar me logon e festivalit "I këndoymë Lirisë" dhe cmimin e parë e ka marr Ansambli I Drenasit të cilët më të drejt thirren në çmimin e parë të FF" I këndoymë Lirisë". Ky festival është themeluar nga ky Kuvend Komunal dhe është legjitim prandaj nuk është dashur që të lejohet që dikush ta keqpërdorë për asnje arsy. Kjo shkon në dëm të komunës para se gjithash. Është formuar një këshill organizativ krejt tjetër, janë larguar është gjitha ata që kanë kontribuar për 20 vite radhazi pasasnje kompensim. Nuk duhet të lejohet që njerëzit ta përdorin këtë festival për hakmarrje private a partiake.

**z. Zenun Elezaj, kryetar I Komunës:** Për shkak të kushteve pandemike, kuvendi ka marrë vendim që këtë vit të mos mbahet festivali "I këndoymë Lirisë". Festivali që është mbajtur nuk ka qenë organizim I Komunës, tjetër kush ka organizuar dhe ndoshta institucionet relevante duhet të marrin masa. Për ujin e pijshëm në Zllakuqan, për vitin e ardhshëm ne kemi në projekt dy impiante për trajtimin e ujërave të zeza dhe kemi dy të tjera të aprovuara nga qeveria e shpresoj që të aprovojen edhe në Kuvend e Kosovës. Këto impiante, ne mendojmë që të l ndërtojmë në Radulloc dhe një në Zllakuqan. Kjo për faktin se furnizimi me ujë të pijshëm bëhet nga rrjedha e Drinit të Bardhë, prandaj ne mendojmë që ta pastrojmë rrjedhjen e Drinit të Bardhë në drejtim të burimit të saj. Në planifikimet tona për vitin e ardhshëm është që për fshatin Ranoc dhe Leskoc të marrim ujin nga fshati Kosh, Komuna e Istogut. Pra, të gjitha përpjekjet dhe përgatitjet tona po shkojnë në drejtim të furnizimit me ujë të pijshëm të fshatrave Ranoc, Leskoc dhe Zllakuqan të bëhet nga burimi- ujësjellësi I Istogut.

**z. Josip Dedaj, Dresnik:** Përshëndetje kryetar, nënkyetar, drejtorë. Unë si kryetar I fshatit Dresnik I kam tri problem pak më të vogëla por më të rëndësishme. Vitin e kaluar ka filluar ndërtimi I kanalizimit për fshatin Dresnik dhe me ardhë me e pa atje se qysh është ndërtuar ai kanalizim është tmerr. Problemi I dytë dhe më I rëndësishëm është rruga. Në 2019 ka qenë në projekt me prioritet, të cilën e keni premtuar ju vetë. Keni thënë se është në projekt të Ministrisë dhe se është projekt I Transitit. Për ne nuk është interes transiti por rruga në drejtim të Klinës. Kemi folur disa herë për këtë rrugë dhe kanalizim por asgjë nuk keni bërë. Ne në Klinë dhe gjitha fshatrat kemi pasur pandeminë. Dikush është përballuar më lehtë më të e dikush më më vështirësi. Unë bashkë me familje kemi qenë të prekur nga kjo sëmundje dhe kemi pasur shumë vështirësi. Ajo që kam parë unë gjatë kësaj kohe në QKMF e Klinës është përfunduar. Kam pasur një rast afër të shtrirë në krevat, një nënë e fshatit Qupevë e cila s'ka pas mjete financiare dhe asgjë. Në të njëjtën kohë kam parë në FB se si janë blerë automjete, janë shtruar prona private me asfalte e ne nuk kemi pasur as infuzione. E kam parë që menaxhimi I në QKMF, stafi, mjekët, motrat meridionale etj. kanë qenë shumë në nivel dhe nuk besoj që kanë qenë diku në


Kosovë më në nivel se këtij por gjithmonë kur ishte nevoja për me na ndihmuar ata I rrudhni krahët në mungesë të iliqeve. Para datës 10 më keni thënë ju se në QKMF, barnat dhe infuzionet janë pa pare, para tre ditëve më thanë në QKMF se s'kanë. Si është puna me këtë pandemi? Nëse nuk ka mundësi të ndihmoj shteti të bëhet një organizim për ndihma vullnetare të njerëzve që kanë mundësi.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Kompania që ka ndërtuar kanalizimin që ju e përmendët është future në listën e zezë dhe si duket kemi shpëtuar nga ajo. Asaj I është ndërprerë kontrata. Në të gjitha fshatrat kemi problem me impiante të kapaciteteve të vogëla. Ne jemi duke bërë përpjekje që të I marrim këto ujëra të zeza dhe përmes një projekti madhor të I trajtojmë. Është projekt I madh dhe do kohë derisa të realizohet, ka gjithashtu implikime të mëdha buxhetore. Për rrugën kemi biseduar vërtetë shumë dhe duhet ta dini që ajo rrugë është pjesë e projektit të transitit. Ne kemi aprovuar buxhetit për këtë vit me kusht që nëse nuk procedohet lënda e transitit ku rruga e juaj është pjesë e saj, atëherë ne me buxhetit Komunal do ta ndërtojmë atë rrugë sepse edhe për mua është shqetësim I Madh. Keni të drejt që ankoheni pasi që ajo rrugë akoma nuk është kryer. Po ashtu do të ndërtohen edhe rrugicat në fshat si dhe pjesa shtesë e kanalizimit. Covid-19 ka sfiduar edhe shtetet më të forta në botë. Fatmirësish ne kemi edhe një specialist të infektives. Kemi pasur problem me furnizim herë pas herë si shkak I mungesës së iliqeve të duhura në treg. Kemi organizuar edhe një mini tender për furnizim me vitaminë C dhe Fraksiparinë por nuk kemi gjetur askund në Kosovë. Vitaminë C ka ardhur më ka lajmëruar Drejtori ndërsa fraksiparina sipas informacioneve që kam është furnizuar Kosova së fundmi. Të falënderoj që keni vlerësim të mirë për stafin e QKMF-së I cili vërtetë është angazhuar shumë. Jam I vetëdijshëm që kosto I trajtimit të kësaj sëmundje është I lartë për ekonominë familjare por besoni që Komuna është duke bërë aq sa po ka mundësi. Jemi duke u munduar që të furnizojmë QKMF-në me barna dhe të I shërbjmë qytetarët. Mirëpo kompetencë për trajtimin e kësaj pandemie është spitali regional. Do të bëjmë të pamundurën që të I dalim në ndihmë qytetarëve.

Në fund të debatit, kryetari Elezaj ja tregoj z. Zefer Gashit, vendimin e tij për ndihmën financiare të ndarë për rastin që dr. Zafi e theksoi në fjalën e tij.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryetari i Komunës

Prof. dr. Zenun Elezaj

